

## KONTRATË SHITJE KUOTE

Në Tiranë, sot në datë 18.06.2019, lidhet kjo Kontratë nga palët si më poshtë:

**Shitësi:** **Znj. Davë Gjoka**, shtetase shqiptare, lindur më 18.06.1944 në Simon, Mirditë e banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 025078072 dhe nr. Personal E45618012L, madhore me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

*(në vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi");*

dhe

**Blerësi:** **Znj. Valentina Gjoka**, shtetase shqiptare, e bija e Frrok, lindur më 01.01.1973 në Mirditë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 028471638 dhe nr. Personal H35101109 O, madhore me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

*(në vijim e për efekt të keaj Kontrate referuar si "Blerësi");*


### MEQENESE:

- A. Shitësi zotëron 100% të Kapitalit të Shoqërisë "TOP LINE" Sh.p.k, një shoqëri e themeluar e që funksionon sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e rregjistruar në Rregjistrin Tregtar Shqiptar me NIPT K21909001C dhe me seli në Tiranë në rrugën "Hodo Beg", Njësia nr.10, Pallati 298, hyrja 16, Tiranë; (më poshtë referuar "Shoqëria");
- B. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit dhe Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi 100 % të Kapitalit të Shoqërisë së lartpërmendur;
- C. Në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin Nr. 9901/2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, si dhe me vendimin Bashkëlidhur të Ortakut të vetëm të Shoqërisë, Palët dëshirojnë të lidhin këtë Kontratë.

**PER SA ME SIPER**, palët bien dakord si vijon:

1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate Shitësi i shet Blerësit dhe Blerësi blen nga Shitësi 100 % të kapitalit të Shoqërisë "Top Line" sh.p.k. Cmimi i shitjes i rënë dakort është 100,000 Lekë (njëqind mijë Lekë) i cili është paguar plotësisht nga blerësi me para në dorë dhe përpara nënshkrimit të kontratës. Palët deklarojnë që nuk kanë asnjë pretendim lidhur me cmimin e shitjes dhe e konsiderojnë atë të shlyer plotësisht.
2. Pronësia mbi kuotat, objekt i kësaj Kontrate, kalon nga Shitësi te Blerësi menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe që nga ky moment Blerësit i lind e drejta e regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
3. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kuota e transferuar këtu, është në pronësinë e tij të plotë e ligjore dhe e lirë nga barra hipoteke apo pengje.
4. Blerësi blen 100 % (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë dhe me nënshkrimin e kësaj Kontrate do të zotërojë 100 % të kapitalit të shoqërisë "Top Line" Sh.p.k. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, struktura e ortakëve të shoqërisë bëhet:

*-Znj. Valentina Gjoka bëhet ortakë e vetme dhe zotëruese e 100 % të kapitalit të shoqërisë.*




5. Bleresi pranon pronësinë e Kuotës duke njohur gjendjen e Shoqërisë dhe bie dakord me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e lindura nga zotërimi i kuotës brenda Shoqërisë, sipas përcaktimeve të Statutit të Shoqërisë dhe ligjit shqiptar.
6. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të zbatojnë dhe të paraqesin që në kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet e nevojshme për rregjistrimin e transferimit të kuotës objekt të kësaj marrëveshjeje, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe në cdo autoritet tjetër Shqiptar sipas përcaktimeve të Ligjit Shqiptar.

Kjo Kontrate u hartua në 3 (tre) origjinale në gjuhën Shqipe. Kontrata bazohet në nenin 705 të Kodit Civil (Shqiptar) dhe në Ligjin shqiptar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare". Nr.9901, datë 14.04.2008. "Marrëveshja u lexua përpara palëve, u gjend e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe u nënshkrua rregullisht nga palët.

#### PALET

**SHITESI**

**Davë Gjoka**



**BLERESI**

**Valentina Gjoka**

